

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Fillim Skoro, kryetar, Have Haliti dhe Xhevdet Abazi anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sadik Kryeziu, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit F.M., av.R.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.915/2013, të datës 27.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, më datë 14.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit F.M., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.915/2013, i datës 27.11.2018, sa i përket vendimit mbi dënimin me burgim, ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarin F.M., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një)viti, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.06.2013, deri më datë 17.09.2013, dhe në arrest shtëpiak prej datës 17.09.2013, deri më dt. 17.11.2013, kurse dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind) €, e merr si të vërtetuar, të cilën gjobë do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në raste se dënimi me gjobë nuk realizohet, dënimi me gjobë do të ekzekutohet në atë mënyrë, që për çdo 20Euro të gjobës së shqiptuar do ti llogaritet një ditë burgim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Mitrovicë, P.nr.915/2013, të datës 27.11.2018, i akuzuari F.M., është shpallur fajtor për veprën penale blerja, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)vit e 6 (gjashtë)muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 500(pesëqind) €, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.06.2013, deri më datë 17.09.2013, si dhe në arrest prej datës 17.09.2013, deri më datë 17.11.2013. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, dënimin me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi do të llogaritet në 20 €.

Të akuzuari i është shqiptuar dënim plotësues, i është konfiskuar substanca narkotike e kanabisit (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) me peshë prej 120.70gr, një peshore digjitale me ngjyrë hiri-e zezë me mbishkrim "MAX 11 lbX0.loz" si dhe para në vlerë prej 1.116 €.

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale e në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) €.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M., av.R.K., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh dhe të njëjtin dënim të ia zëvendësoj me dënim me gjobë.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën nuk prezantuan Prokurori i Apelit, i akuzuari F.M., edhe pse që të gjithë janë njoftuar në mënyrë të rregullt për kohë dhe vendin e mbajtjes së seancës, në seancë prezantoi vetëm mbrojtësi i të akuzuarit av.R.K., i cili e njoftoi gjykatën se i akuzuari jeton dhe punon në Gjermani.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar prishjen e aktgjykimit dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, se me ankesë nuk mund të kontestohet konform nenit 383 par.2 të KPPK-së, se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë, kryetari i trupit gjykues është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M., në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar rrethanat lehtësuese, por ato nuk i ka vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme, se sikur të vlerësoheshin rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë që nga momenti i dhënies së deklaratës në polici, pendimi i tij, se jeton dhe punon në Gjermani dhe në bazë të thirrjes telefonike ka ardhur nga Gjermania, në shqyrtim gjyqësor, se është i martuar, baba i dy fëmijëve, i mban edhe prindërit në Kosovë, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ka propozuar që dënimi ti ulet deri në 6 (gjashtë) muaj dhe i njëjti ti zëvendësohej me dënim me gjobë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73, të KPRK-së, që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e

dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, ka marrë pranimin e fajësisë dhe keqardhjen e shfaqur, se i njëjti pas kryerjes së veprës penale është penduar thellë, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, ndërsa rrethanë rënduese nuk ka gjetur, e në mungesë të rrethanave rënduese i ka aplikuar dispozitat e nenit 76 par.1 lidhur me pikën 1.3 të KPRK-së.

Sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat siç parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, rrethanat lehtësuese që i ka marrë parasysh gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit, për të akuzuarin si pranimin e fajësisë dhe keqardhjen e shfaqur, se i njëjti pas kryerjes së veprës penale është penduar thellë, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, i aprovon edhe kjo gjykatë dhe gjenë se në praninë e rrethanave lehtësuese, e në mungesë të rrethanave rënduese ka vend për uljen e dënimit se i njëjti jeton në Gjermani, e të ardhurat që i fiton e mban edhe familjen në Kosovë dhe është babë i dy fëmijëve dhe me pranimin e fajësisë është vetëdijshëm për veprën penale, i ka kuptuar pasojat e veprimit të tij, se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin të aktgjykimit është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventives gjenerale dhe të asaj individuale dhe në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, konform nenit 403 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.55/19, të dt. 14.02.2019

Procesmbajtësja,
Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit

Kryetarja e kolegjit
Fillim Skoro

2. Have Haliti

3. Xhevdet Abazi